FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 75	**2002**	**Nëntor**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8960 datë 24.10.2002	Për ratifikimin e Kartës Sociale Europiane, e ndryshuar.	2087
Ligj nr. 8971 datë 14.11.2002	Për disa shtesa në ligjin nr. 8113, datë 28.3.1996 "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001…….	2114

L I G J
Nr. 8960, datë 24.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E KARTËS SOCIALE EUROPIANE, E NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohen nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 19, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 28 dhe 29 të Kartës Sociale Europiane, të ndryshuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3539, datë 6.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

Karta Sociale Europiane e Ndryshuar
Strasburg, 3 Maj 1996

HYRJE

Qeveritë nënshkruese të kësaj, duke qënë anëtare të Këshillit të Europës.

Duke konsideruar që synimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllim që të ruajnë dhe realizojnë idealet dhe parimet që janë trashëgimi e tyre e përbashkët dhe për të lehtësuar përparimin ekonomik dhe shoqëror, veçanërisht nëpërmjet ruajtjes dhe realizimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke konsideruar që në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, dhe Protokollet e saj, Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës ranë dakord t'u sigurojnë popullsive të tyre liritë dhe të drejtat politike të specifikuara aty;

Duke konsideruar që në Kartën Sociale Europiane, të hapur për nënshkrim në Torino më 18 tetor 1961, dhe Protokollet e saj, Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës ranë dakord të përmirësojnë standardin e tyre të jetesës dhe mirëqenien e tyre sociale;

Duke rikujtuar që Konferenca Ministrore mbi të Drejtat e Njeriut e mbajtur në Romë më 5 nëntor 1990 theksoi nevojën, nga njëra anë të ruajë natyrën e pandashme të të gjitha të drejtave të njeriut, qofshin ato civile, politike, ekonomike, sociale ose kulturore dhe, nga ana tjetër, t'i japë një impuls të ri Kartës Sociale Europiane;

Të vendosura, siç u vendos gjatë Konferencës Ministrore të mbajtur në Torino më 21 dhe 22 tetor 1991, për të aktualizuar dhe përshtatur përmbajtjen thelbësore të Kartës në mënyrë që të merren parasysh veçanërisht ndryshimet themelore sociale që kanë ndodhur që nga koha kur u miratua teksti;

Duke njohur avantazhin e trupëzimit në një Kartë të ndryshuar, të planifikuar për të zënë progresivisht vendin e Kartës Sociale Europiane, të të drejtave të garantuara nga Karta siç është amenduar, të të drejtave të garantuara nga Protokolli Shtesë i 1988-ës dhe të shtojnë të drejta të reja.

Ranë dakord si më poshtë:

PJESA I

Palët pranojnë si synim të poltikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive:

1. Cilido do të këtë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.

2. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për kushte të drejta pune.

3. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme.

4. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për një pagë të drejtë të mjaftueshme për një standard jetese të përshtatshëm për ata dhe familjet e tyre.

5. Të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit kanë të drejtën e lirisë së shoqërizimit në organizata kombëtare ose ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale.

6. Të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit kanë të drejtë të negociojnë në mënyrë kolektive.

7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen.

8. Gratë e punësuara, në rast të shtatzënisë, kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë.

9. Cilido ka të drejtë për lehtësi të përshtatshme për orientim profesional me synimin që të ndihmohet për të zgjedhur një punë që i përshtatet aftësive dhe interesave të tij profesionale.

10. Cilido ka të drejtë për lehtësi të përshtatshme për trajnim profesional.

11. Cilido ka të drejtë të përfitojë nga çfarëdo masash që i lejojnë atij të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit.

12. Të gjithë punëtorët dhe personat e varur prej tyre kanë të drejtë për sigurim shoqëror.

13. Cilido pa burime të përshtatshme ka të drejtë për asistencë sociale dhe mjekësore.

14. Cilido ka të drejtë të përfitojë nga shërbimet e mirëqenies sociale.

15. Personat e gjymtuar kanë të drejtë për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.

16. Familja si një njësi themelore e shoqërisë ka të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale për të siguruar zhvillimin e saj të plotë.

17. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale.

18. Shtetasit e cilësdo nga Palët kanë të drejtën të angazhohen në punë fitimprurëse në territorin e cilësdo nga të tjerat në bazë barazie me shtetasit e të fundit, duke iu nënshtruar kufizimeve të bazuara në arsye bindëse ekonomike ose shoqërore.

19. Punëtorët emigrantë, të cilët janë shtetas të një Pale, dhe familjet e tyre kanë të drejtë për mbrojtje dhe asistencë në territorin e çdo Pale tjetër.

20. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa dallim mbi bazë seksi.

21. Punëtorët kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen brenda ndërmarrjes.

22. Punëtorët kanë të drejtë të marrin pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisin e punës në ndërmarrje.

23. Çdo person i moshuar ka të drejtë për mbrojtje sociale.

24. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mbrojtje në rast të përfundimit të punësimit.

25. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mbrojtje të pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të punëdhënësit të tyre.

26. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë për dinjitet në punë.

27. Të gjithë personat me përgjegjësi familjare dhe që janë angazhuar ose dëshirojnë të angazhohen në punësim kanë të drejtë ta bëjnë këtë pa iu nënshtruar diskriminimit dhe, sa të jetë e mundur, pa konflikt ndërmjet përgjegjësive të tyre familjare dhe të punësimit.

28. Përfaqësuesit e punëtorëve në ndërmarrje kanë të drejtë për mbrojtje kundër akteve paragjykuese ndaj tyre dhe duhet t'u jepen lehtësi të përshtatshme për të kryer funksionet e tyre.

29. Të gjithë punëtorët kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen në procedura shkurtimesh kolektive nga puna.

30. Cilido ka të drejtë për mbrojtje kundër varfërisë dhe përjashtimit social.

31. Cilido ka të drejtë për strehim.

PJESA II

Palët angazhohen, siç parashikohet në pjesën III, ta konsiderojnë veten të detyruara nga detyrimet e parashtruara në nenet dhe paragrafët e mëposhtme.

Neni 1
E drejta për punë

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen:

1. të pranojnë si një nga synimet dhe përgjegjësitë e tyre parësore arritjen dhe mbajtjen e një niveli sa më të lartë e të qëndrueshëm të mundshëm punësimi, me synim që të arrihet punësim i plotë;

2. të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht;

3. të krijojnë dhe mbajnë shërbime punësimi falas për të gjithë punëtorët;

4. të japin dhe të nxisin orientim, trajnim dhe rihabilitim profesional të përshtatshëm.

Neni 2
E drejta për kushte të drejta pune

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për kushte të drejta pune, Palët angazhohen:

1. të marrin masa për orar pune ditorë e javorë të arsyeshëm, që java e punës të ulet progresivisht në masën që e lejojnë rritja e produktivitetit dhe faktorëve të tjerë përkatës;

2. të marrin masa për ditë pushimi publik të paguara;

3. të marrin masa për një leje vjetore të paguar prej një minimumi prej katër javësh;

4. të eliminojnë rreziqet në punë vetvetisht të rrezikshme ose të pashëndetshme dhe, kur nuk ka qenë akoma e mundur, të eliminojnë ose ulin këto rreziqe mjaftueshëm, të marrin masa ose për një shkurtim të orëve të punës ose për pushime shtesë të paguara për punëtorët e angazhuar në këto punë;

5. të sigurojnë një periudhë javore pushimi, e cila, sa të jetë e mundur, të përkojë me ditën e njohur nga tradita ose zakoni në vendin ose rajonin në fjalë si një ditë pushimi;

6. të sigurojnë që punëtorët të jenë të informuar me shkrim, sa më parë të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se dy muaj pas datës së fillimit të punësimit të tyre, për aspektet thelbësore të kontratës ose marrëdhënies së punësimit;

7. të sigurojnë që punëtorët që bëjnë punë natën të përfitojnë nga masa që marrin parasysh natyrën e veçantë të punës.

Neni 3
E drejta për kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune, Palët angazhohen, në konsultim me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve:

1. të formulojnë, realizojnë dhe rishikojnë periodikisht një politikë kombëtare koherente për sigurimin në punë, shëndetin në punë dhe mjedisin e punës. Synimi parësor i kësaj politike do të jetë përmirësimi i sigurimit dhe shëndetit në punë dhe të parandalohen aksidentet dhe dëmtimet e shëndetit që lindin nga, lidhen me ose ndodhin gjatë punës, veçanërisht duke minimizuar shkaqet e rreziqeve të vetvetishme në mjedisin e punës;

2. të nxjerrin rregullore shëndeti dhe sigurimi;

3. të marrin masa për zbatimin e këtyre rregulloreve me masa mbikëqyrjeje;

4. të nxisin zhvillimin progresiv të shërbimeve të shëndetit në punë për të gjithë punëtorët me funksione thelbësisht parandaluese dhe këshillimore.

Neni 4
E drejta për pagë të drejtë

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për një pagë të drejtë, Palët angazhohen:

1. të njohin të drejtën e punëtorëve për një pagë të tillë që do t'u japë atyre dhe familjeve të tyre një standard të përshtatshëm jetese;

2. të njohin të drejtën e punëtorëve për njësi page të shtuar për punën jashtë orarit, me përjashtime në raste të veçanta;

3. të njohin të drejtën e punëtorëve burra e gra për pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë;

4. të njohin të drejtën e të gjithë punëtorëve për një periudhë të arsyeshme njoftimi për përfundimin e punësimit;

5. të lejojnë zbritjet nga rroga vetëm në kushtet dhe në masën e parashikuar nga ligjet ose rregulloret kombëtare ose të fiksuar në marrëveshjet kolektive ose në vendimet e arbitrazhit.

Ushtrimi i këtyre të drejtave do të arrihet me marrëveshje kolektive të përfunduara lirisht, me mekanizma ligjorë të fiksimit të pagave ose me mjete të tjera të përshtatshme me kushtet kombëtare.

Neni 5

E drejta për t'u organizuar

Me synimin për të siguruar dhe nxitur lirinë e punëtorëve dhe punëdhënësve për të formuar organizata lokale, kombëtare ose ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale dhe për t'u anëtarësuar në ato organizata, Palët angazhohen që legjislacioni kombëtar nuk do të jetë i tillë që të pengojë dhe as do të zbatohet që të pengojë këtë liri. Masa në të cilën këto garanci të dhëna do të zbatohen për policinë do të përcaktohen me ligje ose rregullore kombëtare. Parimi që rregullon zbatimin e këtyre garancive për anëtarët e forcave të armatosura dhe masa në të cilën ato do të zbatohen për personat e kësaj kategorie do të rregullohet gjithashtu me ligje ose rregullore kombëtare.

Neni 6

E drejta për të negociuar kolektivisht

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për të negociuar kolektivisht, Palët angazhohen:

1. të nxisin konsultimet e përbashkëta ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve;

2. të nxisin, ku është e nevojshme dhe e përshtatshme, mekanizmin për negociata vullnetare ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve, me synimin për rregullimin e termave dhe kushteve të punësimit me anë të marrëveshjeve kolektive;

3. të nxisin krijimin dhe përdorimin e mekanizmave të përshtatshëm për pajtim dhe arbitrazh vullnetar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës;

4. dhe njohin të drejtën e punëtorëve dhe të punëdhënësve për veprim kolektiv në rastet e konfliktit të interesave, duke përfshirë të drejtën për grevë, duke iu nënshtruar detyrimeve që mund të lindin nga marrëveshjet kolektive për të cilat është rënë dakord më parë.

Neni 7

E drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje, Palët angazhohen:

1. të marrin masa që mosha minimale për pranim në punësim të jetë 15 vjeç, duke iu nënshtruar përjashtimeve për fëmijët që punojnë në punë të lehtë të përcaktuar të padëmshme për shëndetin, moralin ose arsimimin e tyre;

2. të marrin masa që mosha minimale për pranim në punësim të jetë 18 vjeç përsa u përket punëve të përcaktuara që konsiderohen të rrezikshme ose të pashëndetëshme;

3. të marrin masa që personat të cilët u nënshtrohen akoma arsimit të detyrueshëm nuk do të punësohen në punë të tillë që do t'i pengonte ata nga përfitimi i plotë i arsimimit të tyre;

4. të marrin masa që orët e punës për personat nën 18 vjeç të kufizohen në përputhje me nevojat e zhvillimit të tyre dhe veçanërisht të nevojës së tyre për trajnim profesional;

5. të njohin të drejtën e punëtorëve të rinj dhe punëtorëve nxënës për një rrogë të drejtë ose shpërblime të tjera të përshtatshme;

6. të marrin masa që koha e shpenzuar nga të rinjtë në trajnim profesional gjatë orëve normale të punës me miratimin e punëdhënësve të trajtohet sikur formon pjesë të ditës së punës;

7. të marrin masa që personat e punësuar nën 18 vjeç të kenë të drejtë për pushim vjetor të paguar për një minimum prej katër javësh;

8. të marrin masa që personat nën 18 vjeç të mos punësohen në punë nate, me përjashtim të disa punëve që parashikohen nga ligjet ose rregulloret kombëtare;

9. të marrin masa që personat nën 18 vjeç të punësuar në punë të përcaktuara nga ligjet ose rregulloret kombëtare t'u nënshtrohen kontrolleve periodike mjekësore;

10. të sigurojnë mbrojtje të veçantë kundër rreziqeve fizike dhe morale, ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht kundër atyre që rezultojnë direkt ose indirekt nga puna e tyre.

Neni 8

E drejta e grave të punësuara për mbrojtje të shtatzënisë

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës së grave të punësuara për mbrojtje të shtatzënisë, Palët angazhohen:

1. të marrin masa që, ose nëpërmjet lejes së paguar, ose përfitimeve të përshtatshme nga sigurimet shoqërore ose nëpërmjet përfitimit nga fonde publike, gratë e punësuara të marrin leje para dhe pas lindjes së fëmijës deri në një total prej të paktën katërmbëdhjetë javësh;

2. të konsiderojnë që është e paligjshme për një punëdhënës t'i japë një gruaje njoftim për pushim nga puna që nga momenti që ajo njofton punëdhënësin e saj se është shtatzënë deri në fund të lejes së saj të shtatzënisë, ose t'i japë asaj njoftimin e pushimit në kohë të atillë që afati i njoftimit të përfundojë brenda kësaj kohe;

3. të marrin masa që nënat që ushqejnë foshnjat e tyre me gji të kenë të drejtë për ndërprerje të mjaftueshme të punës për këtë qëllim;

4. të disiplinojnë me rregullore punësimin në punë nate të grave shtatzëna, grave që kanë lindur rishtazi dhe grave që ushqejnë foshnjat me gji;

5. të ndalojnë punësimin e grave shtatzënë, grave që kanë lindur rishtazi ose që ushqejnë foshnjat me gji në miniera nëntokë dhe në çdo punë tjetër që është e papërshtatshme për arsye të natyrës së saj të rrezikshme, të pashëndetëshme ose të rëndë dhe të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat e punësimit të këtyre grave.

Neni 9

E drejta për orientim profesional

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për orientim profesional, Palët angazhohen të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, një shërbim i cili do të ndihmojë të gjithë personat, përfshirë të gjymtuarit, për të zgjidhur problemet lidhur me zgjedhjen dhe përparimin profesional, duke patur parasysh siç duhet karakteristikat individuale dhe lidhjen e tyre me mundësinë e punësimit: kjo asistencë duhet të vihet në dispozicion falas si për të rinjtë, përfshirë fëmijët e shkollave, ashtu edhe për të rriturit.

Neni 10

E drejta për trajnim profesional

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për trajnim profesional, Palët angazhohen:

1. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, trajnimin teknik dhe profesional të të gjithë personave, përfshirë të gjymtuarit, në këshillim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve dhe të japin lehtësitë që lejojnë për pranim në arsimin më të lartë teknik dhe universitar, të bazuar vetëm në aftësitë individuale;

2. të ofrojnë ose nxisin një sistem të punëtorëve nxënës dhe rregullime të tjera sistematike për

trajnimin e djemve dhe vajzave të reja në punësimet e tyre të ndryshme;

3. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme:

a) lehtësi trainimi të përshtatshme dhe lehtësisht në dispozicion për punëtorët e rritur;

b) lehtësi të veçanta për ritrajnimin e punëtorëve të rritur, i nevojshëm si rezultat i zhvillimit teknologjik ose i tendencave të reja në punësim;

4. të ofrojnë ose të nxisin, si të jetë e nevojshme, masa të veçanta për ritrajnimin dhe ri-integrimin e të papunëve afatgjatë;

5. të inkurajojnë përdorimin e plotë të lehtësive të ofruara nëpërmjet masave të përshtatshme të tilla si:

a) ulja ose heqja e ndonjë tarife ose pagese;

b) dhënia e asistencës financiare në rastet e përshtatshme;

c) përfshirja në orët normale të punës e kohës së shpenzuar nga punëtori për trajnim shtesë të kërkuar nga punëdhënësi, gjatë punësimit;

d) sigurimi, nëpërmjet mbikëqyrjes së përshtatshme, në kështillim me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, i efektivitetit të mësimit të punëtorëve nxënës dhe i rregullimeve të tjera për trajnim për punëtorët e rinj dhe mbrojtje e përshtatshme për punëtorët e rinj e në përgjithësi.

Neni 11

E drejta për mbrojtjen e shëndetit

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për mbrojtjen e shëndetit, Palët angazhohen që, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike ose private, të marrin masa të përshtatshme që synojnë, ndër të tjera:

1. për të eliminuar sa më shumë të jetë e mundur shkaqet e shëndetit të keq;

2. për të ofruar lehtësi këshillimi dhe edukimi për nxitjen e shëndetit dhe inkurajimin e përgjegjësisë individuale për çështjet e shëndetit;

3. për të parandaluar sa më shumë të jetë e mundur epidemitë, sëmundjet epidemike e të tjera, si edhe aksidentet.

Neni 12

E drejta për sigurim shoqëror

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për sigurim shoqëror, Palët angazhohen:

1. të krijojnë ose mbajnë një sistem të sigurimit shoqëror;

2. të mbajnë sistemin e sigurimit shoqëror në një nivel të kënaqshëm, të paktën të barabartë me atë të nevojshëm për ratifikimin e Kodit Europian të Sigurimit Shoqëror;

3. të përpiqen të ngrenë sistemin e sigurimit shoqëror në një nivel më të lartë;

4. të ndërmarrin hapa, me përfundimin e marrëveshjeve të përshtatshme dypalëshe dhe shumëpalëshe ose me mjete të tjera, dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në ato marrëveshje, për të siguruar:

a) trajtim të barabartë me atë të shtetasve të tyre, të shtetasve të Palëve të tjera lidhur me të drejtat e sigurimit shoqëror, përfshirë mbajtjen e përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni i sigurimit shoqëror, pavarësisht nga lëvizjet që personat e mbrojtur mund të bëjnë ndërmjet territoreve të Palëve;

b) dhënia, mbajtja dhe rifillimi i të drejtave të sigurimit shoqëror me mjete të tilla si akumulim i periudhave të sigurimit ose punësimit të plotësuara sipas legjislacionit të secilës nga Palët.

Neni 13

E drejta për asistencë mjekësore dhe sociale

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për asistencë mjekësore dhe sociale, Palët angazhohen:

1. të sigurojnë që çdo personi, i cili është pa burime të mjaftueshme dhe i cili nuk ka mundësi të sigurojë këto burime si nëpërmjet përpjekjeve të tij, ashtu edhe nga burime të tjera, veçanërisht nga

përfitimet prej një skeme të sigurimit shoqëror, t'i jepet asistencë e përshtatshme dhe, në rast sëmundjeje, kujdesi i nevojshëm për atë gjendje;

2. të sigurojnë që personat që marrin asistencë të tillë nuk do të vuajnë, për këtë arsye, nga zvogëlimi i të drejtave të tyre politike ose sociale;

3. të marrin masa që cilido të mund të marrë nga shërbimet e përshtatshme, publike ose private, këshilla dhe ndihmë personale, ashtu siç mund të kërkohet për të parandaluar, eliminuar ose lehtësuar gjendjen nevojtare personale ose të familjes;

4. të zbatojnë dispozitat e referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni në mënyrë të barabartë me shtetasit e tyre ndaj shtetasve të Palëve të tjera, që ndodhen ligjërisht brenda territorit të tyre, në përputhje me detyrimet e Konventës Europiane për Asistencën Mjekësore dhe Sociale, të nënshkruar në Paris më 11 dhjetor 1953.

Neni 14

E drejta për të përfituar nga shërbimet e mirëqenies sociale

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për shërbime të mirëqenies sociale, Palët angazhohen:

1. të nxisin ose të ofrojnë shërbime, të cilat, duke përdorur metoda të punës sociale, do të kontribuonin në mirëqenien dhe zhvillimin e individëve dhe grupeve në komunitet dhe përshtatjen e tyre në mjedisin social;

2. të inkurajojë pjesëmarrjen e individëve dhe organizatave vullnetare dhe të tjera në krijimin dhe mbajtjen e shërbimeve të tilla.

Neni 15

E drejta e personave me gjymtime për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit

Me synimin që t'u sigurohet personave me gjymtime, pavarësisht nga mosha dhe natyra e origjina e gjymtimeve të tyre, ushtrimi i të drejtës për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit, Palët angazhohen, në veçanti:

1. të marrin masa të nevojshme që t'u japin personave me gjymtime orientim, arsim dhe trajnim profesional në kuadrin e skemave të përgjithshme kudo që të jetë e mundur ose, ku kjo nuk është e mundur, nëpërmjet organeve të specializuara, publike ose private;

2. të nxisin aksesin e tyre në punësim, nëpërmjet të gjitha masave që tentojnë të inkurajojnë punëdhënësit, të marrin dhe mbajnë në punë persona me gjymtime në mjedisin e zakonshëm të punës dhe të përshtasin kushtet e punës për nevojat e të gjymtuarve ose, ku kjo nuk është e mundur për shkak të gjymtimit, duke rregulluar ose krijuar punësim të mbrojtur në përputhje me nivelin e gjymtimit. Në disa raste, këto masa mund të kërkojnë ndihmën e shërbimeve të specializuara për gjetjen e vendeve të punës dhe mbështetjes;

3. të nxisin integrimin e tyre të plotë social dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit në veçanti nëpërmjet masave, përfshirë ndihmesa teknike, që synojnë të tejkalojnë barrierat e komunikimit dhe lëvizshmërisë dhe duke lejuar aksesin në transport, strehim, veprimtari kulturore dhe të kohës së lirë.

Neni 16

E drejta e familjes për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale

Me synim që të sigurohen kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, që është një njësi themelore e shoqërisë, Palët angazhohen të nxisin mbrojtjen ekonomike, ligjore dhe sociale të jetës së familjes me mjete të tilla si përfitime familjare dhe sociale, rregullime fiskale, dhënia e shtëpive për familje, përfitime për të martuarit rishtas dhe mjete të tjera të përshtatshme.

Neni 17

E drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale

Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve që të rriten

në një mjedis i cili inkurajon zhvillimin e plotë të personalitetit të tyre dhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike, Palët angazhohen që, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike dhe private, të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme, që synojnë për:

1.a) të siguruar që fëmijët dhe të rinjtë, duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, të kenë kujdesin, asistencën, arsimimin dhe trajnimin për të cilin kanë nevojë, veçanërisht, duke marrë masa për krijimin ose mbajtjen e institucioneve dhe shërbimeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme për këtë qëllim;

b) të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë nga neglizhenca, dhuna dhe shfrytëzimi;

c) të ofruar mbrojtje dhe ndihmë të veçantë nga shteti për fëmijët dhe të rinjtë që janë të privuar përkohësisht ose përfundimisht nga mbështetja e familjes;

2. t'u ofruar fëmijëve dhe të rinjve një arsim fillestar dhe të mesëm falas, si dhe të inkurajojnë frekuentimin e rregullt të shkollave.

Neni 18

E drejta për t'u angazhuar në punë fitimprurese në territorin e Palëve të tjera

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për t'u angazhuar në punë fitimprurese në territorin e çdo Pale tjetër, Palët angazhohen:

1. të zbatojnë rregulloret aktuale me frymë liberale;

2. të thjeshtojnë formalitetet ekzistuese dhe të ulin ose të heqin tarifat konsullore dhe pagesa të tjera që paguhen nga punëtorët e huaj ose punëdhënësit e tyre;

3. të liberalizojnë, individualisht ose kolektivisht, rregullat që qeverisin punësimin e punëtorëve të huaj;

4. dhe njohin të drejtën e shtetasve të tyre të largohen nga vendi për t'u angazhuar në punë fitimprurëse në territoret e Palëve të tjera.

Neni 19

E drejta e punëtorëve migrues dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve migrues dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë në territorin e çdo Pale tjetër, Palët angazhohen:

1. të mbajnë ose të jenë kënaqura se mbahen shërbime të përshtatshme falas për të asistuar këta punëtorë, veçanërisht në marrjen e informacioneve të sakta dhe të marrin të gjitha hapat e përshtatshme, aq sa e lejojnë legjislacioni dhe rregulloret kombëtare, kundër propagandës çoroditëse lidhur me emigrimin dhe imigrimin;

2. të marrin masat e përshtatshme brenda juridiksionit të tyre të lehtësojnë nisjen, udhëtimin dhe pritjen e këtyre punëtorëve dhe familjeve të tyre dhe t'u ofrojnë atyre, brenda juridiksionit të tyre, shërbime të përshtatshme për shëndetin, vëmendje mjekësore dhe kushte të mira higjenike gjatë udhëtimit;

3. të nxisin bashkëpunimin, siç është e përshtatshme, ndërmjet shërbimeve sociale, publike dhe private, në vendet e emigrimit dhe imigrimit;

4. të sigurojnë për këta punëtorë, ligjërisht, brenda territorit të tyre, për sa këto çështje rregullohen me ligj ose rregullore ose u nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai i shtetasve të vet lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) pagën dhe kushte të tjera punësimi dhe pune;

b) anëtarësinë në sindikata dhe gëzimin e përfitimeve nga negociatat kolektive;

c) strehimin;

5. të sigurojnë për këta punëtorë ligjërisht brenda territorit të tyre, trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i shtetasve të vet lidhur me taksat, tarifat ose kontributet e punësimit lidhur me personat e punësuar;

6. të lehtësojnë sa të jetë e mundur ribashkimin e familjes së një punëtori të huaj, i cili është lejuar të vendoset në territor;

7. të sigurojnë për këta punëtorë ligjërisht brenda territorit të tyre trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i shtetasve të vet për procedura ligjore lidhur me çështje të referuara në këtë nen;

8. të sigurojë që këta punëtorë, të cilët banojnë ligjërisht brenda territoreve të tyre, të mos

përzihen, përveç se kur rrezikojnë sigurimin kombëtar ose kryejnë shkelje kundër interesit dhe moralit publik;

9. të lejojnë, brenda kufijve ligjorë, transferimin e pjesëve të tilla të fitimeve dhe kursimeve të këtyre punëtorëve siç mund të dëshirojnë ata;

10. të zgjerojnë mbrojtjen dhe asistencën e parashikuar në këtë nen për migrantët e vetëpunësuar, për aq sa këto masa janë të zbatueshme;

11. të nxisin dhe lehtësojnë mësimin e gjuhës kombëtare të shtetit pritës ose, nëse ka disa, të njërës nga ato gjuhë, punëtorëve migrantë dhe pjestarëve të familjeve të tyre;

12. të nxisin dhe lehtësojnë, sa të jetë praktike, mësimin e gjuhës amtare të punëtorëve migrantë për fëmijët e punëtorit migrant;

Neni 20

E drejta e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa diskriminim për shkak të seksit

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa diskriminim për shkak të seksit, Palët angazhohen të njohin atë të drejtë dhe të marrin masa të përshtatshme për të siguruar ose nxitur zbatimin e saj në fushat e mëposhtme:

a) akses në punësim, mbrojtje kundër pushimit nga puna dhe riintegrimit në punë;

b) orientim profesional, trajnim, ritrajnim dhe rihabilitim;

c) kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, duke përfshirë pagën;

d) zhvillimi i karrierës, duke përfshirë ngritjen në përgjegjësi.

Neni 21

E drejta për informim dhe këshillim

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të punëtorëve për t'u informuar dhe këshilluar brenda ndërmarrjes, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë masa që mundësojnë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare:

a) të informohen rregullisht ose në kohë të përshtatshme dhe në një mënyrë gjithëpërfshirëse rreth situatës ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes që i punëson, duke kuptuar që dhënia e disa informacioneve, të cilat mund të paragjykojnë ndërmarrjen, mund të refuzohet ose t'i nënshtrohet konfidencialitetit; dhe

b) të këshillohen në kohë për vendime të propozuara, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme interesat e punëtorëve, veçanërisht për ato vendime që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm për situatën e punësimit në ndërmarrje.

Neni 22

E drejta për të marrë pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisin e punës

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për të marrë pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisit të punës në ndërmarrje, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë masa që mundësojnë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, të kontribuojnë:

a) në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës, organizimin e punës dhe mjedisin e punës;

b) në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimit brenda ndërmarrjes;

c) në organizimin e shërbimeve sociale dhe social-kulturore dhe lehtësive brenda ndërmarrjes;

d) mbikëqyrjen e respektimit të rregulloreve mbi këto çështje.

Neni 23

E drejta e personave të moshuar për mbrojtje sociale

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtave të personave të moshuar për mbrojtje sociale, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike ose private, masa të përshtatshme, që synojnë veçanërisht:

– të mundësojnë personat e moshuar që të mbeten anëtarë të plotë të shoqërisë për sa më gjatë të jetë e mundur, nëpërmjet:

a) burimeve të përshtatshme që mundësojnë ata të bëjnë një jetë të përshtatshme dhe të luajnë një rol aktiv në jetën publike, sociale dhe kulturore;

b) ofrimit të informacionit për shërbimet dhe lehtësitë në dispozicion për personat e moshuar dhe mundësitë e tyre për t'i përdorur ato;

- të mundësojnë personat e moshuar të zgjedhin lirisht mënyrën e tyre të jetesës dhe të bëjnë një jetë të pavarur në mjedisin e tyre familjar për sa kohë që ata e dëshirojnë dhe kanë mundësi ta bëjnë, nëpërmjet:

a) ofrimit të strehimit të përshtatshëm për nevojat e tyre dhe gjendjen e tyre të shëndetit ose mbështetjes së përshtashme për përshtatjen e vendbanimit të tyre;

b) kujdesit shëndetësor dhe shërbimet e nevojshme për gjendjen e tyre;

- garantimit të personave të moshuar që jetojnë në institucione mbështetje, të përshtatshme, duke respektuar privatësinë e tyre dhe pjesëmarrjen në vendime lidhur me kushtet e jetesës në institucion.

Neni 24

E drejta për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimit

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për mbrojtje në rastin e përfundimit të punësimit, Palët angazhohen të njohin:

a) të drejtën e të gjithë punëtorëve që të mos u përfundohet punësimi pa arsye të vlefshme për atë përfundim të lidhura me aftësinë ose sjelljen e tyre ose bazuar në kërkesat operacionale të ndërmarrjes, organizmit ose shërbimit;

b) të drejtën e punëtorëve, punësimi i të cilëve përfundohet pa arsye të vlefshme për kompensim të përshtatshëm ose lehtësim tjetër të përshtatshëm.

Për këtë qëllim, Palët angazhohen të sigurojnë që një punëtor, i cili konsideron që punësimi i tij është përfunduar pa një arsye të vlefshme, do të ketë të drejtën të apelojë në një organ të pavarur.

Neni 25

E drejta e punëtorëve për mbrojtjen e pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të pronarit të tyre

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të punëtorëve për mbrojtjen e pretendimeve të tyre në rastin e falimentimit të punëdhënësit të tyre, Palët angazhohen të ofrojnë që pretendimet e punëtorëve që lindin nga kontrata punësimi ose marrëdhënie punësimi të garantohen nga një institucion garantimi ose nga ndonjë formë tjetër efektive mbrojtjeje.

Neni 26

E drejta e dinjitetit në punë

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve për mbrojtjen e dinjitetit të tyre në punë, Palët angazhohen, në konsultim me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve:

1. të nxisin sensibilizimin ndaj, informimin për, dhe parandalimin e ngacmimit seksual në vendin e punës ose në lidhje me punën dhe të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur punëtorët nga një sjellje e tillë;

2. të nxisin sensibilizimin ndaj, informimin për, dhe parandalimin e veprimeve të dënueshme ose dukshëm negative e ofensive të drejtuara në mënyrë të përsëritur kundër punëtorëve individuale në vendin e punës ose në lidhje me punën dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur punëtorët nga një sjellje e tillë.

Neni 27

E drejta e punëtorëve me përgjegjësi familjare për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për barazi të mundësive dhe trajtimit të punëtorëve burra dhe gra me përgjegjësi familjare dhe ndërmjet këtyre punëtorëve dhe punëtorëve të tjerë, Palët angazhohen:

1. të marrin masa të përshtatshme:

a) të mundësojnë punëtorët me përgjegjësi familjare të hyjnë dhe të mbeten në punësim, si edhe të rihyjnë në punësim pas një mungese për shkak të atyre përgjegjësive, duke përfshirë masat në fushën e orientimit dhe trajnimit profesional;

b) të marrin parasysh nevojat e tyre lidhur me kushtet e punësimit dhe sigurimit shoqëror;

c) të zhvillojnë dhe nxisin shërbime, publike ose private, në veçanti shërbime për kujdesjen e fëmijëve gjatë ditës dhe rregullime të tjera për kujdesjen e fëmijëve;

2 të ofrojnë një mundësi për njërin nga prindit të marrë, gjatë një periudhe pas lejes së shtatzënisë, leje prindërore për t'u kujdesur për fëmijën, kohëzgjatja dhe kushtet e së cilës duhet të përcaktohen nga legjislacioni kombëtar, rregullimet kolektive ose praktika;

3. të sigurojnë që përgjegjësitë familjare nuk do të përbëjnë, si të tilla, një arsye të vlefshme për përfundim të punësimit.

Neni 28

E drejta e përfaqësuesve të punëtorëve për mbrojtje në ndërmarrje dhe lehtësitë që do t'u akordohen atyre

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së përfaqësuesve të punëtorëve që të kryejnë funksionet e tyre, Palët angazhohen të sigurojnë që në ndërmarrje:

a) ata gëzojnë mbrojtje efektive ndaj veprimeve paragjykuese ndaj tyre, duke përfshirë pushimin nga puna, të bazuar mbi statusin e tyre ose veprimtaritë si përfaqësues të punëtorëve brenda ndërmarrjes;

b) atyre t'u vihen në dispozicion lehtësi, siç mund të jenë të përshtatshme, në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të shpejtë dhe efektive, duke marrë në konsideratë sistemin e marrëdhënieve industriale të vendit dhe nevojat, përmasat dhe mundësitë e ndërmarrjes në fjalë.

Neni 29

E drejta për informacion dhe këshillim në procedurat e shkurtimeve kolektive

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës së punëtorëve që të informohen dhe këshillohen në situata të shkurtimeve kolektive, Palët angazhohen të sigurojnë që punëdhënësit do të informojnë dhe këshillohen me përfaqësuesit e punëtorëve, në afat kohe të dobishëm para këtyre shkurtimeve kolektive, për mënyrat dhe mjetet për të evituar shkurtime kolektive ose kufizimin e ndodhjes së tyre dhe zbutjes së pasojave të tyre, për shembull duke iu drejtuar masave sociale shoqëruese, që synojnë veçanërisht të ndihmojnë për rivendosjen ose ritrajnimin e punëtorëve në fjalë.

Neni 30

E drejta e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, Palët angazhohen:

a) të marrin masa brenda kuadrit të një përqasjeje të përgjithshme dhe të koordinuar për të nxitur aksesin efektiv të personave që jetojnë ose rrezikojnë të jetojnë në një situatë të përjashtimit shoqëror ose varfëri, si edhe të familjeve të tyre, veçanërisht në punësim, strehim, trajnim, arsimim, kulturë dhe asistencë sociale dhe mjekësore;

b) të rishikojnë këto masa, me synim që t'i përshtasin ato, nëse është e nevojshme.

Neni 31
E drejta për strehim

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për strehim, Palët angazhohen të marrin masa që synojnë:

1. të nxisin aksesin në strehim të një standardi të mjaftueshëm;
2. të parandalojnë dhe ulin numrin e të pastrehëve me synim të eliminimit të tij gradual;
3. të bëjnë çmimin e strehimit të arritshëm nga ata pa burime të mjaftueshme.

PJESA III

Neni A
Angazhime

1. Duke iu nënshtruar dispozitave të nenit B më poshtë, secila nga Palët angazhohet:

a) ta konsiderojë pjesën I të kësaj Karte si një deklaratë të qëllimeve, të cilat ajo do të ndjekë me të gjitha mjetet e përshtatshme, siç është deklaruar në paragrafin hyrës të saj;

b) ta konsiderojë veten të detyruar nga të paktën gjashtë prej neneve të mëposhtme të pjesës II të kësaj Karte: nenet 1, 5, 6, 7 ,12, 13, 16,19 dhe 20;

c) ta konsiderojë veten të detyruar nga një numër shtesë nenesh ose paragrafësh me numër të pjesës II të Kartës që mund t'i zgjedhë, me kusht që numri i përgjithshëm i neneve ose paragrafëve me numër nga të cilat do të detyrohet të mos jetë më i vogël se gjashtëmbëdhjetë nene ose gjashtëdhjetë e tre paragrafë me numër.

2. Nenet ose paragrafët e zgjedhura në përputhje me nënparagrafët b dhe c të paragrafit 1 të këtij neni i njoftohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në kohën kur depozitohet instrumenti i ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Çdo Palë mundet, në një datë të mëvonshme, të deklarojë, me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm, që ajo konsideron veten të detyruar nga cilatdo nene ose paragrafe të numëruara të pjesës II të Kartës, të cilat ajo nuk i kishte pranuar tashmë sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni. Këto angazhime do të konsiderohen më tej të jenë pjesë përbërëse e ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe do të kenë të njëjtin efekt që nga dita e parë e muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës së njoftimit.

4. Çdo Palë do të mbajë një sistem të inspektimit të punës të përshtatshëm me kushtet kombëtare.

Neni B
Lidhjet me Kartën Sociale Europiane dhe Protokollin Shtesë të 1998-ës

1. Asnjë Palë e Kartës Sociale Europiane ose Palë në Protokollin Shtesë të 5 Majit 1988 nuk mund të ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Kartë pa e konsideruar veten të detyruar nga të paktën dispozitat që i korrespondojnë dispozitave të Kartës Sociale Europiane dhe, ku është e përshtatshme, të protokollit shtesë, nga të cilat ka qenë e detyruar.

2. Pranimi i detyrimeve të çdo dispozite të kësaj Karte do të rezultojë, nga data e hyrjes në fuqi e atyre detyrimeve për Palën në fjalë, në pushimin e qenies në fuqi për Palën në fjalë të dispozitave korresponduese të Kartës Sociale Europiane dhe, ku të jetë e përshtatshme, të protokollit të saj shtesë të 1998-ës, në rastin kur ajo Palë ka qenë e detyruar nga i pari ose të dy këto instrumente.

PJESA IV

Neni C
Mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që përmbahen në këtë Kartë

Zbatimi i detyrimeve ligjore që përmbahen në këtë Kartë do t'i nënshtrohet të njëjtës mbikëqyrje si Karta Sociale Europiane.

Sistemi i mbikëqyrjes është paraqitur në pjesën IV të Kartës, e cila është përfshirë më poshtë;

amendamentet e vendosura nga Protokolli i Torinos paraqitën me gërma të zeza në të djathtë.

"PJESA IV

Neni 21
Raport për dispozitat që janë pranuar

Palët Kontraktuese do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në formën që do të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave, raporte dyvjeçare mbi zbatimin e dispozitave të kreut II të Kartës që ata kanë pranuar.

Neni 22
Raport për dispozitat që nuk janë pranuar

Palët Kontraktuese do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm, në intervale të përshtatshme kohe dhe me kërkesën e Komitetit të Ministrave, raporte për dispozitat e kreut II të Kartës, të cilat nuk janë panuar prej tyre as në kohën e ratifikimit ose të miratimit, as edhe pas një njoftimi të mëvonshëm. Komiteti i Ministrave do të përcaktojë, në intervale të rregullta, se për cilat dispozita do të kërkohen raporte dhe cilat do të jenë kërkesat për to.

Neni 23
Përcjellja e kopjeve

1. Çdo Palë Kontraktuese do t'i përcjellë kopje të raporteve që parashikojnë nenet 21 dhe 22 organizatave kombëtare të saj, të cilat kanë aderuar në organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve e të punonjësve dhe që, në përputhje me nenin 27 paragrafi 2, do të ftohen të përfaqësohen në takimet e Nënkomitetit të Komitetit Social Qeveritar.

2. Palët Kontraktuese do t'i transmetojnë Sekretarit të Përgjithshëm të gjitha vërejtjet e bëra nga ana e këtyre organizatave kombëtare rreth raporteve në fjalë, në qoftë se kërkohet një gjë e tillë prej tyre.

"Neni 23
Komunikimi i kopjeve të raporteve dhe komenteve

1. Çdo Palë Kontraktuese, kur i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm një raport sipas neneve 21 dhe 22, do t'i dërgojë një kopje të atij raporti organizatave të saj kombëtare, të tilla që janë anëtarë të organizatave ndërkombëtare të punëdhënësve dhe sinidikatave të ftuara, sipas nenit 27 paragrafit 2, që të përfaqësohen në takime të Komitetit Qeveritar. Ato organizata do t'i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm çfarëdo komentesh mbi raportet e Palëve Kontraktuese. Sekretari i Përgjithshëm do t'i dërgojë një kopje të atyre komenteve Palëve Kontraktuese në fjalë, të cilat mund të dëshirojnë të përgjigjen.

2. Sekretari i Përgjithshëm do t'i dërgojë një kopje të raporteve të Palëve Kontraktuese organizatave joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë status konsultativ me Këshillin e Europës dhe kanë kompetencë të veçantë në çështjet e qeverisura nga kjo Kartë.

3. Raportet dhe komentet e referuara në nenet 21 dhe 22 dhe në këtë nen do t'i vihen në dispozicion publikun kundrejt kërkesës.

Neni 24
Shqyrtimi i raporteve

Raportet që i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenet 21 dhe 22 do të shqyrtohen nga një komitet ekspertësh, i cili do të disponojë gjithashtu të gjitha vërejtjet që i janë transmetuar Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 2 të nenit 23.

Neni 24
Shqyrtimi i raporteve

1. Raportet e dërguara Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me nenet 21 dhe 22 do të shqyrtohen nga një Komitet Ekspertësh të Pavarur të krijuar në bazë të nenit 25. Komiteti do të jetë përpara gjithashtu çfarëdo komentesh të paraqitura Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 1 të nenit 23. Në përfundim të shqyrtimit të tij, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të hartojë një raport që përmban konkluzionet e tij.

2. Lidhur me raportet e referuara në nenin 21, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të vlerësojë nga një pikëpamje juridike përputhshmërinë e legjislacionit dhe praktikës kombëtare me detyrimet që rrjedhin nga Karta për Palët Kontraktuese në fjalë.

3. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund t'i bëjë kërkesa për informacion shtesë dhe sqarim drejtpërdrejt Palëve Kontraktuese. Lidhur me këtë, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund, gjithashtu, në se është e nevojshme, të bëjë mbledhje me përfaqësuesit e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e tij ose me kërkesën e Palës Kontraktuese në fjalë. Organizatat e referuara në paragrafin 1 të nenit 23 do të mbahen të informuara.

4. Konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur do të bëhen publike dhe do t'i komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm Komitetit Qeveritar, Asamblesë Parlamentare dhe organizatave që janë përmendur në paragrafin 1 të nenit 23 dhe paragrafin 2 të nenit 27.

Neni 25
Komiteti i Ekspertëve

1. Komiteti i Ekspertëve do të ketë në përbërjen e tij jo më shumë se shtatë anëtarë, që do të caktohen nga Komiteti i Ministrave nga një listë ekspertësh të pavarur të integritetit më të lartë dhe me kompetenca të njohura në çështje sociale ndërkombëtare, të cilët do të propozohen nga Palët Kontraktuese.

2. Anëtarët e Komitetit do të jenë të emëruar për 6 vjet; mandati i tyre mund të ripërtërihet. Megjithatë, mandati i dy prej anëtarëve të emëruar për herë të parë do të mbarojë në fund të një periudhe prej katër vjetësh.

3. Anëtarët, mandati i të cilëve mbaron në fund të periudhës fillestare prej katër vjetësh, do të zgjidhen me short nga Komiteti i Ministrave menjëherë pas emërimit të parë.

4. Një anëtar i Komitetit të Ekspertëve, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar të cilit nuk i ka mbaruar mandati, do të përmbushë periudhën që ka mbetur nga mandati i paraardhësit të tij.

Neni 25
Komiteti i Ekspertëve të Pavarur

1. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të përbëhet nga të paktën nëntë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Parlamentare me një shumicë votash të dhëna për një listë ekspertësh me standardin më të lartë të ndershmërisë dhe me kompetenca të mirënjohura në çështjet sociale kombëtare e ndërkombëtare, të emëruar nga Palët Kontraktuese. Nunri i saktë i anëtarëve do të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave.

2. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen për një periudhë prej gjashtë vjetësh. Ata mund të rizgjidhen një herë.

3. Një anëtar i Komitetit të Ekspertëve të Pavarur, i zgjedhur për të zëvendësuar një anëtar, afati i të cilit nuk ka mbaruar, do të qëndrojë në post për pjesën që mbetet nga afati i paraardhësit të tij.

4. Anëtarët e Komitetit do të kryejnë funksionin me titull individual. Gjatë gjithë kohës së afatit të tyre, ata nuk mund të kryejnë asnjë funksion në mospërputhjen me kërkesat për pavarësi, paanësi dhe të qenit në dispozicion që kërkohen nga funksioni i tyre.

Neni 26
Pjesëmarrja në Organizatën Ndërkombëtare të Punës

Organizata Ndërkombëtare e Punës do të ftohet të emërojë një përfaqësues për të marrë pjesë

me status konsultativ në diskutimet e Komitetit të Ekspertëve.

Neni 27
Nënkomiteti i Komitetit Social Qeveritar

1. Raportet e Palëve Kontraktuese dhe konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve do t'i paraqiten për shqyrtim një nënkomiteti të Komitetit Social Qeveritar të Këshillit të Evropës.

2. Nënkomiteti do të ketë në përbërjen e tij një përfaqësues nga çdo Palë Kontraktuese. Ai do të ftojë jo më shumë se dy organizata ndërkombëtare të punonjësve për të marrë pjesë si vëzhgues me status konsultativ në mbledhjet e tij. Përveç të tjerash, ai mund të thërrasë në konsultim pranë Këshillit të Evropës jo më shumë se dy përfaqësues të organizatave ndërkombëtare joqeveritare, që kanë status konsultativ, për çështje të tilla si përkrahja sociale dhe mbrojtja ekonomike dhe shoqërore e familjes, për trajtimin e të cilave këto organizata janë veçanërisht të kualifikuara.

3. Nënkomiteti do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave një raport me konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve. Asambleja Konsultative do t'i transmetojë mendimin e saj për këto konkluzione Komitetit të Ministrave.

Neni 27
Komiteti Qeveritar

1. Raportet e Palëve Kontraktuese, komentet dhe informacionet e komunikuara në përputhje me paragrafët 1 të nenit 23 dhe 3 të nenit 24 dhe raportet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur do t'i paraqiten një Komiteti Qeveritar.

2. Komiteti do të përbëhet nga një përfaqësues prej secilës Palë Kontraktuese. Ai do të ftojë jo më shumë se dy organizata ndërkombëtare të punëdhënësve dhe jo më shumë se dy organizata sindikale ndërkombëtare që të dërgojnë vëzhgues me aftësi konsultative në mbledhjet e tij. Për më tepër, ai mund të konsultohet me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë një status konsultativ në Këshillin e Europës dhe kanë kompetenca të veçanta në çështjet që qeverisen nga kjo Kartë.

3. Komiteti Qeveritar do të përgatisë vendimet e Komitetit të Ministrave. Në veçanti, në dritën e raporteve të Komitetit të Ekspertëve të Pavarur dhe të Palëve Kontraktuese, ai do të zgjedhë, duke dhënë arsye për zgjedhjen e tij, në bazë të konsideratave të politikave sociale, ekonomike dhe të tjera për situatat të cilat, sipas opinionit të tij, do të jenë tema e rekomandimeve për secilën Palë Kontraktuese në fjalë, në përputhje me nenin 28 të Kartës. Ai do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave një raport i cili do të bëhet publik.

4. Në bazë të gjetjeve të tij për zbatimin në përgjithësi të Kartës Sociale në përgjithësi, Komiteti Qeveritar mund t'i paraqesë propozime Komitetit të Ministrave, që synojnë në kryerjen e studimeve për çështje sociale dhe për nenet e Kartës të cilat mundet të aktualizohen.

Neni 28
Asambleja Konsultative

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i përcjellë Asamblesë Konsultative konkluzionet e Komitetit të Ekspertëve. Asambleja Konsultative do t'i transmetojë mendimin e saj për këto konkluzione Komitetit të Ministrave.

Neni 28
Komiteti i Ministrave

1. Komiteti i Ministrave do të miratojë, me një shumicë prej dy të tretash të votuesve, me të drejtën e votimit të kufizuar në Palët Kontraktuese, në bazë të raportit të Komitetit Qeveritar, një rezolutë që mbulon gjithë ciklin e mbikëqyrjes dhe që të përmbajë rekomandime individuale për Palët Kontraktuese në fjalë.

2. Duke mbajtur parasysh propozimet e bëra nga Komiteti Qeveritar sipas paragrafit 4 të nenit 27, Komiteti i Ministrave do të marrë vendime, siç e sheh të arsyeshme.

Neni 29
Komiteti i Ministrave

Komiteti i Ministrave, në bazë të raportit të nënkomitetit dhe pas konsultimit me Asamblenë Konsultative, mund t'i bëjë çdo Palë Kontraktuese rekomandimet e nevojshme, me një shumicë të përbërë nga dy të tretat e anëtarëve që kanë të drejtë të jenë anëtarë të Komitetit."

Neni 29
Asambleja Parlamentare

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë Asamblesë Parlamentare, me synimin e mbajtjes së debateve plenare periodike, raportet e Komitetit të Ekspertëve të Pavarur dhe të Komitetit Qeveritar, si edhe rezolutat e Komitetit të Ministrave."

Neni D
Ankesat kolektive

1. Dispozitat e Protokollit Shtesë të Kartës Sociale Europiane, që parashikojnë një sistem ankesash kolektive, do të zbatohen për angazhimet e marra në këtë Kartë për shtetet të cilat kanë ratifikuar Protokollin e përmendur.

2. Çdo, Shtet i cili nuk është i detyruar nga Protokolli Shtesë i Kartës Sociale Europiane që parashikon një sistem të ankesave kolektive mundet, që kur të depozitojë instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Karte ose në një kohë të mëvonshme, të deklarojë me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që ai pranon mbikëqyrjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Karte duke ndjekur procedurën e parashikuar në Protokollin në fjalë.

Procedura e ankesave kolektive është paraqitur në Protokollin Shtesë të Kartës të vitit 1995, teksti i të cilit është përfshirë më poshtë:

"Neni 1

Palët Kontraktuese të këtij Protokolli njohin të drejtën e organizatave të mëposhtme për të paraqitur ankesa që pretendojnë zbatimin e pakënaqshëm të Kartës:

a) organizata ndërkombëtare të punëdhënësve dhe sindikata të referuara në paragrafin 2 të Nenit 27 të Kartës;

b) organizata të tjera joqeveritare ndërkombëtare, të cilat kanë një status konsultativ me Këshillin e Europës dhe janë vendosur në një listë të krijuar për këtë qëllim nga Komiteti Qeveritar;

c) organizata kombëtare përfaqësuese të punëdhënësve dhe sindikata brenda juridiksionit të Palës Kontraktuese, kundër së cilës ata kanë bërë një ankesë.

Neni 2

1. Çdo Shtet Kontraktues mundet, gjithashtu, kur ai shpreh miratimin e tij të detyrohet nga ky Protokoll, në përputhje me dispozitat e nenit 13, ose në çdo moment më pas, të deklarojë që ai njeh të drejtën e çdo organizate tjetër joqeveritare kombëtare përfaqësuese brenda juridiksionit të tij që ka kompetenca të veçanta në çështjet e qeverisura nga Karta, që të bëjë ankesë kundër tij.

2. Këto deklarata mund të bëhen për një periudhe specifike.

3. Deklaratat do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, i cili do t'i transmetojë kopje të tyre Palëve Kontraktuese dhe do t'i botojë ato.

Neni 3

Organizatat joqeveritare ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare kombëtare, të referuara respektivisht në nenin 1.b dhe nenin 2, mund të paraqesin ankesa në përputhje me procedurën e përshkruar nga dispozitat e lartpërmendura vetëm në lidhje me ato çështje për të cilat ato janë njohur

të kenë kompetencë të veçantë.

Neni 4

Ankesa do të depozitohet me shkrim, do të lidhet me një dispozitë të Kartës të pranuar nga Pala Kontraktuese në fjalë dhe do të tregojë se në çfarë drejtimi kjo e fundit nuk ka siguruar zbatimin e kënaqshëm të kësaj dispozite.

Neni 5

Çdo ankesë do t'i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do të konfirmojë marrjen e saj, do t'ia njoftojë atë Palës Kontraktuese në fjalë dhe do t'ia transmetojë atë menjëherë Komitetit të Pavarur të Ekspertëve.

Neni 6

Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund t'i kërkojë Palës Kontraktuese në fjalë dhe organizatës që depozitoi ankesën që të paraqesin informacion dhe vërejtje me shkrim për pranueshmerinë e ankesës brenda afatit që ai do të rekomandojë.

Neni 7

1. Nëse vendos që ankesa është pranueshme, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të njoftojë Palët Kontraktuese të Kartës nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Ai do t'i kërkojë Palës Kontraktuese në fjalë dhe organizatës që depozitoi ankesën që të paraqesë, brenda afatit që ai do të rekomandojë, të gjitha shpjegimet ose informacionet me shkrim, dhe Palët Kontraktuese të tjera në këtë Protokoll, komentet që ato dëshirojnë të paraqesin, brenda të njëjtit afat kohor.

2. Nëse ankesa është depozituar nga një organizatë kombëtare e punëdhënësve ose sindikatë kombëtare ose nga ndonjë organizatë tjetër kombëtare ose ndërkombëtare joqeveritare, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të njoftojë organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve ose të sindikatave, të referuara në paragrafin 2 të nenit 27 të Kartës, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, dhe do t'i ftojë ata të paraqesin vërejtje brenda afatit që ai do të rekomandojë.

3. Në bazë të shpjegimeve, informacionit ose vërejtjeve të paraqitura nën paragrafët 1 dhe 2 më lart, Pala Kontraktuese në fjalë dhe organizata që depozitoi ankesën mund të paraqesin çfarëdo informacioni ose vërejtjeje shtesë me shkrim brenda afatit që do të rekomandojë Komiteti i Ekspertëve të Pavarur.

4. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur mund të organizojë një dëgjim me përfaqësues të palëve.

Neni 8

1. Komiteti i Ekspertëve të Pavarur do të hartojë një raport në të cilin ai do të përshkruajë hapat e ndërmarra prej tij për shqyrtimin e ankesës dhe të paraqesë konkluzionet në se Pala Kontraktuese në fjalë ka siguruar zbatimin e kënaqshëm të dispozitës së Kartës, që referohet në ankesë.

2. Raporti do t'i transmetohet Komitetit të Ministrave. Ai do t'i transmetohet gjithashtu organizatës që depozitoi ankesën dhe Palës Kontraktuese të Kartës, e cila nuk do të ketë lirinë ta botojë atë.

Ai do t'i transmetohet Asamblesë Parlamentare dhe do të bëhet publik në të njëjtën kohë me rezolutën e referuar në nenin 9 ose jo më vonë se katër muaj pasi ai i është transmetuar Komitetit të Ministrave.

Neni 9

1. Në bazë të raportit të Komitetit të Ekspertëve të Pavarur, Komiteti i Ministrave do të

miratojë një rezolutë me shumicën e votuesve. Nëse Komiteti i Ekspertëve të Pavarur konstaton që Karta nuk është zbatuar në mënyrë të kënaqshme, Komiteti i Ministrave do të miratojë, me shumicë dy të tretash të votuesve, një rekomandim që i adresohet Palës Kontraktuese në fjalë. Në të dy rastet, e drejta për të votuar do të kufizohet në Palët Kontraktuese të Kartës.

2. Me kërkesën e Palës Kontraktuese në fjalë, Komiteti i Ministrave mund të vendosë, me shumicë dy të tretash të Palëve Kontraktuese të Kartës, të këshillohet me Komitetin Qeveritar, aty ku raporti i Komitetit të Ekspertëve të Pavarur ngre çështje të reja.

Neni 10

Pala Kontraktuese në fjalë do të japë informacion mbi masat që ka marrë për të vënë në fuqi rekomandimin e Komitetit të Ministrave, në raportin e ardhshëm që ajo i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 21 të Kartës.

Neni 11

Nenet 1 deri 10 të këtij Protokolli do të zbatohen edhe për nenet e pjesës II të Protokollit të parë Shtesë të Kartës në lidhje me Shtetet Palë në atë Protokoll, në masën që këto nene janë pranuar.

Neni 12

Shtetet Palë në këtë Protokoll konsiderojnë që paragrafi i parë i shtojcës së Kartës, lidhur me pjesën III, lexohet si vijon:

“Kuptohet që Karta përmban detyrime juridike të karakterit ndërkombëtar, zbatimi i të cilave i nënshtrohet vetëm mbikëqyrjes së parashikuar në pjesën IV të saj dhe në dispozitat e këtij Protokolli."

PJESA V

Neni E
Mosdiskriminimi

Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.

Neni F
Derogimi në kohë lufte ose emergjence publike

1. Në kohë lufte ose emergjence tjetër publike që kërcënon jetën e kombit, çdo Palë mund të marrë masa derogimi nga detyrimet sipas kësaj Karte në masën që kërkohet rigorozisht nga nevojat e situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në mospërputhje me detyrimet e tjera të saj sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Çdo Palë që ka shfrytëzuar këtë të drejtë derogimi do të informojë plotësisht Sekretarin e Përgjithshëm, brenda një afati kohe të arsyeshëm, për masat e marra dhe për arsyet e tyre. Ajo, gjithashtu do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm kur këto masa kanë pushuar së funksionuari dhe kur dispozitat e Kartës, të cilat ajo ka pranuar, janë duke u zbatuar përsëri plotësisht.

Neni G
Kufizime

1. Të drejtat dhe parimet e parashikuara në pjesën I, kur realizohen në mënyrë efektive, dhe ushtrimi i tyre efektiv siç parashikohet në pjesën II, nuk do t’u nënshtrohen asnjë kufizimi që nuk specifikohet në ato pjesë, përveçse atyre të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve ose për mbrojtjen e interesave

publike, të sigurimit kombëtar, shëndetit ose moralit publik.

2. Kufizimet e lejuara sipas kësaj Karte për të drejtat dhe detyrimet e parashikuara këtu nuk do të zbatohen për asnjë qëllim tjetër përveçse për atë për të cilin janë parashikuar.

Neni H

Marrëdhëniet ndërmjet Kartës dhe të drejtës kombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Karte nuk do të paragjykojnë dispozitat e së drejtës kombëtare ose të çfarëdo traktati dypalësh ose shumëpalësh, konvente ose marrëveshjeje që është tashmë në fuqi, ose mund të hyjë në fuqi, nën të cilën personave të mbrojtur do t'u jepej trajtim më i favorshëm.

Neni I

Zbatimi i angazhimeve të marra

1. Pa paragjykim për metodat e zbatimit të parashikuara në këto nene, dispozitat përkatëse të neneve 1 deri 31 të pjesës II të kësaj Kartë do të zbatohen nëpërmjet:

a) ligjeve dhe rregullave;

b) marrëveshjeve ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të punëtorëve;

c) një kombinimi të atyre dy metodave;

d) mjeteve të tjera të përshtatshme.

2. Respektimi i angazhimeve që rrjedhin nga dispozitat e paragrafëve 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 të nenit 2, paragrafëve 4, 6 dhe 7 të nenit 7, paragrafëve 1, 2, 3 dhe 5 të nenit 10 dhe neneve 21 dhe 22 të pjesës II të kësaj Karte do të konsiderohet si efektiv, nëse dispozitat zbatohen, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, për shumicën dërrmuese të punëtorëve në fjalë.

Neni J

Ndryshime

1. Çdo ndryshim i pjesëve I dhe II të kësaj Karte me qëllim që të zgjerohen të drejtat dhe garancitë e garantuara nga kjo Kartë, si edhe çdo ndryshim i pjesëve III dhe IV, propozuar nga një Palë ose nga Komiteti Qeveritar, do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe do t'i dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm Palëve të kësaj Karte.

2. Çdo ndryshim i propozuar në përputhje me dispozitat e paragrafit paraardhës do të shqyrtohet nga Komiteti Qeveritar, i cili do t'i paraqesë tekstin e miratuar prej tij Komitetit të Ministrave për miratim pas këshillimeve me Asamblenë Parlamentare. Pas miratimit të tij nga Komiteti i Ministrave, ky tekst do t'u dërgohet Palëve për pranim.

3. Çdo ndryshim i pjesëve I dhe II të kësaj Karte do të hyjë në fuqi për ato Palë që e kanë pranuar atë, në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën tre Palë kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

Për çdo Palë që e pranon atë më pas, ndryshimi do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën ajo Palë ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e saj.

4. Çdo ndryshim në pjesët III dhe IV të kësaj Karte do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

PJESA VI

Neni K

Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Kartë do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit dhe miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Kartë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën tre Shtete Anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur konfirmimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Kartë në përputhje me paragrafin paraardhës.

3. Lidhur me çdo Shtet Anëtar që shpreh më vonë miratimin e tij për t'u detyruar nga kjo Kartë, ajo do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të periudhës prej një muaji pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni L
Zbatimi territorial

1. Kjo Kartë do të zbatohet në territorin metropolitan të çdo Pale. Çdo nënshkrues mundet që, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të specifikojë, me deklaratë adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, territorin që do të konsiderohet të jetë territori i tij metropolitan për këtë qëllim.

2. Çdo nënshkrues mundet të deklarojë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të intrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose në një kohë më pas, me anë të një njoftimi adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që Karta do të shtrihet në të gjithë ose një pjesë të territorit ose territoreve të tij jometropolitanë, të specifikuara në deklaratën në fjalë, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës ose për të cilat ai merr përgjegjësi ndërkombëtare. Ai do të specifikojë në deklaratë nenet ose paragrafët e pjesës II të Kartës të cilat ai pranon si detyruese lidhur me territoret e përmendura në deklaratë.

3. Karta do të shtrijë zbatimin e saj në territorin ose territoret e përmendura në deklaratën në fjalë nga dita e parë e muajit pas kalimit të një periudhe prej një muaji pas datës së marrjes së njoftimit të kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Çdo Palë mund të deklarojë në një datë të mëvonëshme me njoftim të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që, lidhur me një ose më shumë nga territoret e të cilëve Karta është zbatuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, ajo pranon si detyruese çfarëdo nenesh ose paragrafësh me numër, të cilat ajo nuk i ka pranuar tashmë lidhur me atë territor ose territore. Këto angazhime të mëvonëshme do të konsiderohen të jenë pjesë tërësore e deklaratës fillestare lidhur me territorin në fjalë dhe do të këtë të njëjtin efekt që nga dita e parë e muajit që vijon kalimin e një periudhe prej një muaji pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni M
Denoncimi

1. Çdo Palë mund të denoncojë këtë Kartë vetëm në fund të një periudhe prej pesë vjetësh nga data në të cilën Karta ka hyrë në fuqi për të ose në fund të çfarëdo periudhe vijuese prej dy vjetësh dhe, në secilin rast, pasi të ketë njoftuar gjashtë muaj më parë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do të njoftojë për këtë Palët e tjera.

2. Çdo Palë mundet të denoncojë, në përputhje me dispozitat e parashikuara në paragrafin paraardhës, çdo nen ose paragraf të pjesës II të Kartës të pranuar prej tij, me kusht që numri i neneve ose paragrafëve nga të cilat ajo Palë është e detyruar nuk do të jetë asnjëherë më i vogël se gjashtëmbëdhjetë për të parat dhe gjashtëdhjetë e tre për të dytat dhe ky numër nenesh ose paragrafësh do të vazhdojë të përfshijë nenet e zgjedhura nga Pala ndërmjet atyre të cilat janë cituar veçanërisht në nenin A, paragrafi 1, nënparagrafi b.

3. Çdo Palë mund të denoncojë këtë Kartë ose çdonjërin prej neneve ose paragrafëve të pjesës II të Kartës sipas kushteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni lidhur me çdo territor për të cilin kjo Kartë është e zbatueshme, me anë të një deklaratë të bërë në përputhje me paragrafin 2 të nenit L.

Neni N
Shtojcë

Shtojca e kësaj Karte do të jetë pjesë tërësore e saj.

Neni O
Njoftime

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për:

a) çdo firmosje;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Karte në përputhje me nenin K;

d) çdo deklaratë të bërë në zbatim të neneve A, paragrafët 2 dhe 3, D, paragrafët 1 dhe 2, F, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4;

e) çdo ndryshim në përputhje me nenin J;

f) çdo denoncim në përputhje me nenin M;

g) çdo akt tjetër, njoftimi ose komunikimi lidhur me këtë Kartë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Kartë të ndryshuar.

Bërë në Strasburg, më 3 maj 1996, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë autentikë, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara çdo Shteti Anëtar të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

SHTOJCË E KARTËS SOCIALE EUROPIANE TË NDRYSHUAR

Fushështrirja e Kartës Sociale Europiane të Ndryshuar
përsa u përket personave të mbrojtur

1. Pa paragjykuar nenin 12, paragrafi 4, dhe nenin 13, paragrafi 4, personat e mbuluar nga nenet 1 deri 17 dhe 20 deri 31 përfshijnë të huajt vetëm për sa ata janë shtetas të Palëve të tjera që banojnë ligjërisht ose punojnë rregullisht brenda territorit të Palës në fjalë, duke iu nënshtruar kuptimit që këto nene duhet të interpretohen në frymën e dispozitave të neneve 18 dhe 19.

Ky interpretim nuk do të paragjykonte zgjerimin e lehtësive të ngjashme në persona të tjerë nga asnjë prej Palëve.

2. Secila Palë do t'u garantojë refugjatëve, siç janë përkufizuar në Konventën lidhur me Statusin e Refugjatëve, nënshkruar në Gjenevë më 28 korrik 1951 dhe në Protokollin e 31 Janarit 1967, dhe që qëndrojnë ligjërisht në territorin e saj, trajtim sa më të favorshëm të mundshëm, dhe në çdo rast jo më pak të favorshëm se sipas detyrimeve të pranuara nga Pala në konventën e përmendur dhe sipas çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar ekzistues i zbatueshëm për ata refugjatë.

3. Secila Palë do t'u japë personave të pashtet, siç janë përkufizuar në Konventën mbi Statusin e Personave të Pashtet, të bërë në Nju Jork më 28 shtator 1954 dhe që qëndrojnë ligjërisht në territorin e saj, trajtim sa më të favorshëm të mundshëm dhe në çdo rast jo më pak të favorshëm sesa sipas detyrimeve të pranuara nga Pala në atë instrument dhe sipas çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar ekzistues i zbatueshëm për ata persona pa shtet.

Pjesa I, paragrafi 18, dhe pjesa II, neni 18, paragrafi 1

Kuptohet që këto dispozita nuk lidhen me çështjen e hyrjeve në territoret e Palëve dhe nuk paragjykojnë dispozitat e Konventës Europiane për Vendosjen, nënshkruar në Paris më 13 dhjetor 1955.

PJESA II

Neni 1, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk do të interpretohet sikur ndalon ose autorizon ndonjë dispozitë ose praktikë për sigurinë sindikale.

Neni 2, paragrafi 6

Palët mund të marrin masa që kjo dispozitë nuk do të zbatohet:

a) për punëtorët që kanë një kontratë ose marrëdhënie punësimi për një kohëzgjatje të përgjithëshme që nuk kalon një muaj dhe/ose me një javë pune që nuk kalon tetë orë;

b) aty ku kontrata ose marrëdhënia e punësimit është e një natyre rastësore dhe/ose specifike, me kusht, në këto raste, që moszbatimi i saj të justifikohet nga konsiderata objektive.

Neni 3, paragrafi 4

Kuptohet që, për qëllimet e kësaj dispozite, funksionet, organizimi dhe kushtet e veprimit të këtyre shërbimeve do të vendosen nga ligje ose rregullore kombëtare, marrëveshje kolektive ose mjete të tjera të përshatshme për kushtet kombëtare.

Neni 4, paragrafi 4

Kjo dispozitë do të kuptohet që të mos ndalojë pushimin e menjëhershëm në rastin e një shkeljeje të rëndë.

Neni 4, paragrafi 5

Kuptohet që një Palë mund të marrë angazhimin që kërkohet në këtë paragraf nëse shumica dërmuese e punëtorëve nuk lejohet të pësojë ulje pagash as me ligj as me marrëveshje ose vendime arbitrazhi, duke bërë përjashtim për ata persona që nuk mbulohen në këtë mënyrë.

Neni 6, paragrafi 4

Kuptohet që çdo Palë mundet, për aq sa i intereson, të rregullojë me ligj ushtrimin e të drejtës për të bërë grevë, me kusht që çdo kufizim i mëtejshëm që kjo mund të përbëjë mbi të drejtën të mund të justifikohet nën kushtet e nenit G.

Neni 7, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk parandalon Palët nga marrja e masave në legjislacionin e tyre që të rinjtë, të cilët nuk kanë arritur moshën minimale të përcaktuar, të mund të kryejnë punë, për aq sa është absolutisht e nevojshme për trajnimin e tyre profesional për të cilin kryhet kjo punë, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent, dhe merren masa që të mbrohet shëndeti dhe siguria e atyre të rinjve.

Neni 7, paragrafi 8

Kuptohet që një Palë mund të japë angazhimin e kërkuar në këtë paragraf nëse ajo plotëson frymën e angazhimit, duke parashikuar me ligj që shumica dërmuese e personave nën tetëmbëdhjetë vjeç nuk do të punësohen në punë nate.

Neni 8, paragrafi 2

Kjo dispozitë nuk do të interpretohet të përcaktojë një ndalim absolut. Përjashtime mund të bëhen, për shembull, në rastet e mëposhtme:

a) në se një grua e punësuar ka qënë plotësisht fajtore për shkelje që justifikon marrëdhënien e punësimit;

b) në se ndërmarrja në fjalë pushon së funksionuari;

c) në se kohëzgjatja e përcaktuar në kontratën e punësimit ka përfunduar.

Neni 12, paragrafi 4

Fjalët “dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këto marrëveshje” në hyrje të këtij paragrafi merren që të kuptojnë ndër të tjera se lidhur me përfitimet që janë në dispozicion pavarësisht nga ndonjë kontribut sigurimi, një Palë mund të kërkojë plotësimin e një periudhe të përcaktuar qëndrimi para se t’u japë këto përfitime shtetasve të Palëve të tjera.

Neni 13, paragrafi 4

Qeveritë jo Palë në Konventën Europiane për Asistencën Mjekësore dhe Sociale mund të ratifikojnë Kartën lidhur me këtë paragraf, me kusht që ato t’u japin shtetasve të Palëve të tjera një trajtim që është në përputhje me dispozitat e konventës në fjalë.

Neni 16

Kuptohet që mbrojtja e dhënë në këtë dispozitë mbulon familjet me një prind.

Neni 17

Kuptohet që kjo dispozitë mbulon të gjithë personat nën 18 vjeç, përveçse kur sipas ligjit fëmija quhet madhor më herët, pa paragjykuar dispozitat e tjera specifike të parashikuara nga Karta, veçanërisht nenin 7.

Kjo nuk nënkupton një detyrim për të dhënë arsim të detyruar deri në moshën e përmendur më lart.

Neni 19, paragrafi 6

Për qëllimin e zbatimit të kësaj dispozite, termi “familje e një punëtori të huaj” kuptohet se do të thotë të paktën gruan dhe fëmijët e pamartuar të punëtorit, për sa kohë këta të fundit konsiderohen të mitur nga shteti pranues dhe varen nga punëtori migrant.

Neni 20

1. Kuptohet që çështjet e sigurimit social, si edhe dispozita të tjera lidhur me përfitimet për papunësinë, përfitimet e pleqërisë dhe përfitimet e mbijetesës, mund të përjashtohen nga fushështrirja e këtij neni.

2. Dispozitat lidhur me mbrojtjen e grave, veçanërisht lidhur me shtatzëninë, qëndrimin në shtrat dhe periudhën pas lindjes, nuk do të kuptohen të jenë diskriminim sipas referimit në këtë nen.

3. Ky nen nuk do të ndalojë adaptimin e masave specifike që synojnë të heqin pabarazitë faktike.

4. Aktivitetet e punës, të cilat, për arsye të natyrës së tyre ose kontekstit në të cilin kryhen, mund t’u besohen vetëm personave të një seksi të caktuar, mund të përjashtohen nga fushështrirja e këtij neni ose e disa prej dispozitave të tij. Kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet sikur u kërkon Palëve të përfshijnë në ligje ose rregullore një listë punësh, të cilat, për arsye të kontekstit në të cilin kryhen, mund t’u rezervohen personave të një seksi të caktuar.

Nenet 21 dhe 22

1. Për qëllimin e zbatimit të këtyre neneve, termi “përfaqësues të punëtorëve”do të thotë persona që njihen si të tillë sipas legjislacionit ose praktikës kombëtare.

2. Termat “legjislacion dhe praktikë kombëtare” përmbledhin, sipas rastit, përveç ligjeve dhe rregulloreve, marrëveshje kolektive, marrëveshje të tjera ndërmjet punëdhënësve dhe përfaqësuesve të punëtorëve, zakone dhe vendime gjyqësore lidhur me to.

3. Për qëllimin e zbatimit të këtyre neneve, termi “ndërmarrje” kuptohet se i referohet një tërësie komponentësh të prekshëm dhe të paprekshëm, me ose pa personalitet juridik, e formuar për të

prodhuar mallra ose për të ofruar shërbime për fitim financiar dhe me kompetenca për të përcaktuar politikën e saj të tregut.

4. Kuptohet që bashkësitë fetare dhe institutet e tyre mund të përjashtohen nga zbatimi i këtyre neneve, edhe nëse këto institute janë "ndërmarrje" brenda kuptimit të paragrafit 3. Organizmat që ndjekin aktivitete që frymëzohen nga disa ideale ose të udhëhequra nga disa koncepte të caktuara morale, ideale dhe koncepte që mbrohen nga legjislacioni kombëtar, mund të përjashtohen nga zbatimi i këtyre neneve në masë të atillë që është e nevojshme për të mbrojtur orientimin e ndërmarrjes.

5. Kuptohet që aty ku në një shtet të drejtat e parashikuara në këto nene ushtrohen në organizmat e ndryshme të ndërmarrjes, Pala në fjalë do të konsiderohet se përmbush detyrimet e saj që rrjedhin nga këto dispozita.

6. Palët mund të përjashtojnë nga fusha e zbatimit të këtyre neneve, ato ndërmarrje që punësojnë më pak se një numër të caktuar punëtorësh, që do të përcaktohet nga legjislacioni dhe praktika kombëtare.

Neni 22

1. Kjo dispozitë nuk ndikon as kompetencat dhe detyrimet e shteteve lidhur me adaptimin e rregulloreve të shëndetit dhe sigurimit për vendet e punës, as kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ngarkuara me kontrollin e zbatimin e tyre.

2. Termat "lehtësi dhe shërbime sociale dhe social-kulturore" kuptohen se u referohen lehtësive sociale dhe/ose kulturore për punëtorët të ofruara nga ndërmarrje të tilla si për asistencë mirëqenieje, fusha sportit, dhoma për nënat me foshnja në gji, biblioteka, kampe pushimesh për fëmijë, etj.

Neni 23, paragrafi 1

Për qëllimin e zbatimit të këtij paragrafi, termi "për sa më gjatë të jetë e mundur" i referohet kapaciteteve fizike, intelektuale dhe psikologjike të personit të moshuar.

Neni 24

1. Kuptohet që për qëllimin e këtij neni, termat "përfundim i punësimit" dhe "përfunduar" do të thonë përfundimin e punësimit me inisiativën e punëdhënësit.

2. Kuptohet që ky nen përfshin të gjithë punëtorët, por që një Palë mund të përjashtojë nga e gjithë mbrojtja ose një pjesë e saj kategoritë e mëposhtme të personave të punësuar:

a) punëtorët e angazhuar me një kontratë punësimi për një periudhë të caktuar kohe ose një detyrë të caktuar;

b) punëtorët që janë në një periudhë prove ose periudhë kualifikimi të punësimit, me kusht që kjo të përcaktohet paraprakisht dhe të jetë me një kohëzgjatje të arsyeshme;

c) punëtorët e angazhuar me bazë rastësore për një periudhë të shkurtër.

3. Për qëllimet e këtij neni sa më poshtë, veçanërisht, nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:

a) anëtarësia në sindikata ose pjesëmarrja në veprimtari sindikale jashtë orëve të punës ose, me miratimin e punëdhënësit, brenda orëve të punës;

b) të kërkuarit e një pozite si përfaqësues i punëtorëve, të vepruarit ose të vepruarit në të kaluarën në funksionin e përfaqësuesit të punëtorëve;

c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelje të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente;

d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzënia, besimi fetar, opinioni politik, prejadhja kombëtare ose origjina sociale;

e) leje shtatzënie ose leje prindërore;

f) mungesa e përkohëshme nga puna për shkak sëmundjeje ose dëmtimi.

4. Kuptohet që kompensimi ose mjete të tjera të përshtatshme lehtësimi në rastin e përfundimit të punësimit pa arsye të vlefshme do të përcaktohet nga ligjet ose rregulloret kombëtare, marrëveshjet kolektive ose mjete të tjera të përshtatshme për kushtet kombëtare.

Neni 25

1. Kuptohet që autoriteti kombëtar kompetent mundet, nëpërmjet përjashtimit dhe pas konsultimeve me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve, të përjashtojë disa kategori punëtorësh nga mbrojtja që u jepet në këtë dispozitë për arsye të natyrës së veçantë të marrëdhënies së tyre të punësimit.

2. Kuptohet që përkufizimi i termit "falimentim"duhet të përcaktohet nga ligjet dhe praktika kombëtare.

3. Pretendimet e punëtorëve të përfshira në këtë dispozitë do të përfshijnë të paktën:

a) pretendimet e punëtorëve për paga lidhur me një periudhë të përcaktuar, e cila nuk do të jetë më e shkurtër se tre muaj në një sistem privilegji dhe tetë javë në një sistem garancie, para falimentimit ose përfundimit të punësimit;

b) pretendimet e punëtorëve për pagë pushimi, që u takon si rezultat i punës së kryer gjatë vitit në të cilin ndodhi falimentimi ose përfundimi i punësimit;

c) pretendimet e punëtorëve për shuma që u takojnë lidhur me mungesa të paguara, lidhur me një periudhë të përcaktuar, e cila nuk do të jetë më e shkurtër se tre muaj në një sistem privilegji dhe tetë javë në një sistem garancie, para falimentimit ose përfundimit të punësimit.

4. Ligjet dhe rregulloret kombëtare mund të kufizojnë mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve në një shumë të caktuar, e cila do të jetë në nivel të pranueshëm nga pikëpamja sociale.

Neni 26

Kuptohet që ky nen nuk kërkon nga Palët që të miratojnë ligje.

Kuptohet që paragrafi 2 nuk përfshin ngacmimin seksual.

Neni 27

Kuptohet që ky nen zbatohet për punëtorë burra dhe gra me përgjegjësi familjare lidhur me fëmijët në vartësi, si edhe lidhur me anëtarë të tjerë të familjes së tyre të ngushtë që kanë nevojë qartësisht për kujdesin ose mbështetjen e tyre ku këto përgjegjësi kufizojnë mundësitë e tyre për t'u përgatitur për aktivitet ekonomik, për të hyrë ose për të përparuar në të. Termat "fëmijë në vartësi" dhe "anëtarë të tjerë të familjes së tyre të ngushtë që kanë nevojë qartësisht për kujdesin dhe mbështetjen e tyre" do të thotë persona që përkufizohen të tillë nga legjislacioni kombëtar i Palës në fjalë.

Nenet 28 dhe 29

Për qëllimin e zbatimit të këtij neni , termi "përfaqësuesit e punëtorëve" do të thotë persona që njihen si të tillë në legjislacionin ose praktikën kombëtare.

PJESA III

Kuptohet që Karta përmban detyrime ligjore të një karakteri ndërkombëtar, zbatimi i të cilave u nënshtrohet vetëm mbikëqyrjes që parashikohet në pjesën IV të saj.

Neni A, paragrafi 1

Kuptohet që paragrafët e numëruara mund të përfshijnë nene që konsistojnë në vetëm një paragraf.

Neni B, paragrafi 2

Për qëllimin e paragrafit 2 të nenit B, dispozitat e Kartës së ndryshuar korrespondojnë me dispozitat e Kartës me të njëjtin nen ose numër paragrafi me përjashtim të:

a. neni 3, paragrafi 2, i Kartës së ndryshuar që korrespondon me nenin 3, paragrafet 1 dhe 3, të

Kartës;

b. neni 3, paragrafi 3 i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me nenin 3, paragrafi 2 dhe 3, të Kartës;

c. neni 10, paragrafi 5, i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me Nenin 10, paragrafi 4, të Kartës;

d. Neni 17, paragrafi 1, i Kartës së ndryshuar i cili korrespondon me nenin 17 të Kartës.

PJESA V

Neni E

Një trajtim i diferencuar i bazuar në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv nuk do të konsiderohet diskriminues.

Neni F

Termat "në kohë lufte dhe emergjencë tjetër civile" do të kuptohen në atë mënyrë që të përfshijnë gjithashtu kërcënimin e luftës.

Neni I

Kuptohet që punëtorët që përjashtohen në përputhje me shtojcën e neneve 21 dhe 22 nuk merren parasysh në përbërjen e numrit të punëtorëve në fjalë.

Neni J

Termi "ndryshim"do të zgjerohet që të përfshijë edhe shtesën e neneve të reja në Kartë.

L I G J
Nr. 8971, datë 14.11.2002

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8113, DATË 28.3.1996 "PËR DEKORATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8765, DATË 2.4.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 8113, datë 28.3.1996 "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001, bëhen shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:
"12. Medalja e Mirënjohjes".

Neni 2

Pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/2
Medalja e Mirënjohjes

Kjo medalje u jepet qytetarëve shqiptarë ose të huaj, në raste festash zyrtare dhe ngjarjesh historike. Medalja të jetë e artë.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3566, datë 19.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 21. 11. 2002
Doli nga shtypi më 22. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë